



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 4852 /2017

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 12, 40, Rregulloren e Punës së Kuvendit të Komunës neni 15 shkronja (c), Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 10.07.2017 merr:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E GRUPIT PUNUES PËR HARTIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për themelimin e grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit të komunës për vitin 2018.

II

Grupit punues për hartimin e planit të punës së kuvendit përbehet prej 5 anëtarëve dhe i njëjti do të ketë këtë përbërje:

1. Qamush Brava - AAK
2. Mirsad Shkreta - VV
3. Akif Shkreta - VV
4. Nora Ballazhi - LDK
5. Florim Shkreta - PDK

III

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës –MAPL, si dhe pas publikimit në webfaqen zyrtare të komunës.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Anëtarët e Komisionit, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data:10.07.2017





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 5110 /2017

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike 03/L-048 neni 45.4, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 63.2, 75, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 10.07.2017 merr:

VENDIM

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR PERIUdhËN JANAR-QERSHOR PËR VITIN 2017

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për raportin e shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar -Qershor për vitin 2017.

II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar-Qershor 2017 i hartuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa. Buxheti i miratuar për vitin fiskal 2017 është në shumë prej 2,046,534.01 €, ndërsa ai përfundimtar është 2,492,726.15 € (duke përfshirë edhe bartjen e të hyrave vetanake në shumë prej 86,192.14 €). Në kategorinë paga dhe mëditje shpenzimi është në shumë prej 685,092.40 € apo 49.16%, në kategorinë mallra dhe shërbime shpenzimi është në shumë prej 39,708.76 € apo 21.93%, në kategorinë ekonomike shpenzime komunale shpenzimi është në shumë prej 21,602.55 € apo 48.02%, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere shpenzimi është në shumë prej 22,827.60 € apo 44.33%, në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale shpenzimi është në shumë prej 50,928.90 € apo 6.20%. Totali i shpenzimit është në shumë prej 820,160.21 € apo 32.90%. Të hyrat vetanake për periudhën Janar- Qershor janë arkëtuar në shumë prej 132,734.58 € apo 55.34 % e planit të të hyrave.

III

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Shërbimi i Arkivit.

Hani i Elezit

Data: 10.07.2017

